

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTAR: LAZER SALLAKU

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Azeta Dede**, sot me **dt. 28.09.2015**, në Tiranë, me pjesmarrjen e prokurores **Mirela Zavalani (Çano)** mori në shqyrtim ne seancë gjyqësore publike kërkesën penale, qe i perket:

KERKUES : Q.P., i biri A. dhe A., dtl. 14.04.19....., lindur e banues ne Tirane, Rr. "H.....", pallati 75, shk.1, ap.3, me arsim te mesem, i martuar, tre femije, i padenuar, me shtetsi Shqiptare, perfaqesuar ne gjykim nga Av. Ervin Çabej.

OBJEKTI: Kthimin e sendeve te sekuestruara.

BAZA LIGJORE: Nenet 217, 218, 301/2 te Kodit Te Procedures Penale

Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore publike, dëgjoi perfaqesuesin e kërkuarit që përfundimisht kërkoi: "Shfuqizimin e vendimit date 20.07.2015 te Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Tirane. Lenien ne fuqi te vendimit date 09.07.2015 te Prokurorise se Rrethit Gjyqësor Tirane".

Prokuroren, e cila në diskutimet perfundimtare kerkoj: Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në prova.

Gjykata, pasi shqyrtoj çështjen në tërësi,

VEREN

Kerkuesi Q. P. i eshte drejtuar gjykates me kerkesen me objekt "Kthimin e sendeve te sekuestruara", kërkesë kjo e paraqitur në gjykatë Brenda afateve të parashikuara nga neni 301/2 i K.Pr.Penale.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se, nga kërkuarit Q. P., në cilësinë e kallëzuesit në procedimin penal nr. të vitit 2015 për veprën penale të parashikuar nga neni 186/3 i K.Penal, aktualisht në fazën e hetimit, është

kërkuar kthimi i sendit të sekuestruar automjet i markës Benz Mercedes E 270, CDI, ngjyrë gri, me targa TR U.

Nga ana e prokurorise eshte regjistruar procedimin penal nr. datë 12.05.2015, për veprën penale të "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186/3 i K.Pena1.

Nga hetimi ke rezultuar se shtetasi Q. P. ka patur në pronësi një automjet të markës "Mercedes Benz", tip 211 (E270 CDI), autoveturë, ngjyrë gri, vit prodhimi 2003, me targa TR L, të cilin e ka blerë rreth viteve 2005 - 2006. Në vitin 2007 këtë automjet ia ka lënë në përdorim në mirëbesim (pa akt shkresor), shtetasit G. T., me të cilin ka patur marrëdhënie biznesi për ndërtimin e një objekti në Durrës. Së fundmi kallëzues i ka mësuar se për këtë automjet figuron një kontratë dhurimi me nr. rep, nr. kol, dt. 07.09.2007, hartuar prej noterës A. S., me palë "dhurues" - Q. P. dhe "pranues" - V. G. T..

Kallëzuesi ka pretenduar se në këtë kontratë nuk është nënshkrimi i tij dhe kjo kontratë është falsifikuar, fakt i cili rezultoi edhe nga akti i ekspertimit grafik shkrimi e nënshkrimi nr., dt. 30.06.2015 të Drejtorisë së Policisë Shkencore Tiranë.

Mbi këtë bazë nga ana e prokurorisë është vendosur sekuestrimi i këtij mjeti dhe lënia në ruajtje kallëzuesit Q.P., vendim i cili u ekzekutua me dt. 16.07.2015.

Po me date 16.07.2015 shtetasi V. T. ka paraqitur në këtë prokurori kërkesë për lënien në ruajtje të këtij automjeti deri në përfundim të çështjes, pasi ka ngritur disa pretendime.

Me pas me vendimin e dates 20.7.2015 Prokuroria e Rrethi Gjyqesor Tirane ka vendosur qe mjeti tip Mercedes-Benz E270 ti lihet ne ruajtje shtetasit V. T. deri ne perfundim te hetimeve.

Por ky vendimi i dates 20.7.2015, eshte i padrejte pasi në "Akt Ekspertimin Grafik Shkrimi Nenshkrimi" nr date 30.06.2015 rezulton se dokumenti "Akt Dhurimi Pasurie e Luajtshme" me nr Rep. dhe nr Kol date 07.09.2007, nuk eshte nenshkruar nga shtetasi Q. P..

Ky fakt tregon se pronarë i sendit të sekuestruar është kërkuesi Q. P..

Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesit është e bazuar dhe automjeti i markes "Mercedes Benz" tip 211 (E270 CDI), autoveture, ngjyre gri, vit prodhimi 2003, me targe TR.....L, duhet ti lihet ne ruajtje kerkesit Q. A. P., deri ne perfundim te hetimeve te procedimit penal Nr. te vitit 2015.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 301/2 e 379 te K.Pr.Penale

VENDOSI

1. Shfuqizimin e vendimit date 27.07.2015, te Prokurores Mirela Zavalani (Çano), persa i takon lenies ne ruajtje te shtetasit V. G. Tirana te automjetit te markes "Mercedes Benz" tip 211 (E270 CDI), autoveture, ngjyre gri, vit prodhimi 2003, me targe TR.....L.
2. Lenien e automjetit te markes "Mercedes Benz" tip 211 (E270 CDI), autoveture, ngjyre gri, vit prodhimi 2003, me targe TR.....L, ne ruajtje kerkuesit Q. A. P., deri ne perfundim te hetimeve te procedimit penal Nr. te vitit 2015.
3. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kerkuesit.
4. Kundër vendimit lejohet ankim brënda 10 ditëve duke filluar nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall në Tirane sot me datë 28.09.2015.

SEKRETARE

AZETA DEDE

GJYQTAR

LAZER SALLAKU